




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar / Pranimja: Më/Dana: 06.07.2012

Nr./ organi Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednoesi
	04-111/831		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË
OPŠTINA VITINA, MUNICIPAL VITI
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PUNË SOCIALE

04.Nr. 78/17
Më 06.07.2012.

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe në mbështetje të Ligjit për Shëndetësi dhe statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Punë Sociale shpallë këtë:

KONKURSPUBLIK

Institucioni: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti
Titulli i vendit të punës: Mjek i Mjekësisë së Përgjithshme (2 vende pune)
Kategoria funksionale/Grada: H - 27

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Shkollimi i kërkuar: Të kenë arsimim universitar .

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen: Të kenë të mbaruar fakultetin, përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë trajnime të veçanta, të jenë të licencuar, si dhe të kenë njohuri të mira për funksionimin e sistemit shëndetësor të Kosovës;
-Të kenë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të kenë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim, njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme, ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Detyrat e punës për profilet e kërkuara me konkurs janë parashikuar me Ligjin e Shëndetësisë dhe statutin e QKMF-së.

KUSHTET: Përveç kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

Kandidatët që konkurojnë për këto vende të punës, kërkesës (aplikacionit) duhet t'ia bashkëngjitin edhe këto dokumente:

- Dëshminë e kualifikimit përkatës ,
- Licencën e punës ,
- Çertifikatën e lindjes ,
- Fotokopjen e letërnjoftimit ,
- Çertifikatën që ndaj tij /saj nuk zbatohën hetimet ,
- Çertifikatën shëndetësore.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas shpalljes.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën e Arhivës të Komunës së Vitisë nr.1



DREJTORI / DSHPS-së,
Xhevat Haziqi